



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 24.1.2025

Nr: 3

Ora: 13:30

VENDIM

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pikat 12 dhe 13, nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

I. Në tekstin e vendimit nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 4 të kreut V, shtohet pika me përmbajtjen si vijon:

“Gjatë procesit të administrimit të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë vendit, KQZ i përcjell DPGjC-së, çdo ditë të Hënë, listën e shtetasve të cilëve iu është miratuar kërkesa për regjistrim. Kjo listë gjenerohet në mënyrë automatike nga Platforma Elektronike e Regjistrimit (PER) dhe i përcillet DPGjC-së në format elektronik. DPGjC merr masa të hartojë dhe publikojë ekstraktin e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit të cilëve u është miratuar kërkesa për regjistrim, brenda 24 orëve, sipas përbërësve të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit të përcaktuar në këtë vendim.

Një kopje e ekstraktit të listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, e hartuar nga DPGjC, i vihet në dispozicion KQZ-së e cila e publikon atë në faqen zyrtare të internetit.”.

II. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, për zbatimin e tij.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 24.1.2025 Nr: 3
Ora: 13:30



“Për një shtesë në vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”

IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar